



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 dhjetor 2023
Nr.ref.: RK 2308/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI200/22

Parashtrues

Svetlana Pavić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev.nr.383/2021 të 18 korrikut
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Svetlana Pavić, nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.383/2021] të 18 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.20/17] e 15 janarit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Aktgjykimin i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës, më 19 shtator 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia Para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe 14 (Ndalimi i Diskriminimit) Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 13 dhjetor 2022, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në postë, e cila në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) arriti dhe u regjistrua më 15 dhjetor 2022.
8. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [Nr.GJR.KI200/22] e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtarë raportues dhe me Vendimin [Nr.KSH.KI200/22] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzie Istrefi-Peci, anëtarë.
10. Më 23 janar 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dorëzoi Gjykatës Supreme.

11. Më 23 janar 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të bashkëngjijë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin [Rev.nr. 383/2021], e 18 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme.
12. Më 31 janar 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar, ku përmes saj informoi Gjykatën se parashtrueses së kërkesës Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar, më 19 shtator 2022.
13. Më 7 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës, rezulton se bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses së kërkesës Goroljub Pavic nga Gjiilani ishte shfrytëzues i një lokali-barake në Gjiilan, e cila gjendej në parcelën kadastrale 4520, të regjistruar në listën poseduese numër 7139, KK në Gjiilan (pronë e Komunës së Gjiilanit), me përmasa 6.8 metra me 4.0 metra, që përfaqëson një sipërfaqe prej rreth 30 m². Bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, i ndjeri Goroljub Pavic, duke marrë pjesë në një konkurs publik, në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, me vendim të Komunës së Gjiilanit, kishte marrë në shfrytëzim një pjesë të tokës në parcelën kadastrale 4520 që të vendoste këtë objekt, me qëllim që të ushtroj profesionin e avokatisë, pasi që ai ishte avokat me profesion. Ai kishte ushtruar profesionin e tij në atë objekt deri në korrik të vitit 1999, kur objekti ishte hapur kafiteri dhe ishte shfrytëzuar deri në shtator 1999.
15. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjiilanit – Biblioteka e Qytetit kishte marrë objektin në posedim dhe ia kishte dhënë me qira për librari një personi tjetër.
16. Më 11 prill 2001, Komuna e Gjiilanit kishte nxjerrë vendimin nr.01-1894-020, përmes të cilit iu kishte bërë thirrje pronarëve të objekteve që ndodhen në token komunale që të aplikojnë përsëri për marrjen e tokës në shfrytëzim.
17. Më 14 nëntor 2008, bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës kishte lidhur kontratë nr.784-25 me Komunën e Gjiilanit, me të cilën bashkëshortit të parashtrueses i ishte dhënë në shfrytëzim toka ndërtimore për ushtrimin e aktivitetit të tij të avokatit, por pa ndërrim destinimi. E paditura në këtë rast Komuna e Gjiilanit e rrënoi objektin e përkohshëm e paditëses, për shkak se në bazë të kontratës ajo kishte të drejtë ta bënte këtë në situatën kur ndërrohet destinacioni i objektit.
18. Më 1 prill 2009, Komuna e Gjiilanit e kishte njoftuar me shkrim bashkëshortin e parashtrueses së kërkesës për largimin e objektit të përkohshëm.
19. Më 6 shtator 2012, objekti – kioska është larguar nga ana e Komunës së Gjiilanit.
20. Në një datë të pasaktësuar parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore kundër Komunës së Gjiilanit – Biblioteka e Qytetit dhe SH.O nga Gjiilani, për shkak të pasurimit të pabazë, pasi që siç deklaroi, Biblioteka e Qytetit “Fan S. Noli” në Gjiilan dhe i padituri i tretë Shefki Osmani, ish-drejtor i bibliotekës, pa asnjë bazë ligjore dhe pa autorizim i kanë dhënë me qira lokalin afarist të paditëses, librarisë “Toena” në Gjiilan, për shumën monetare mujore prej 90 €, që kjo librari ia ka paguar bibliotekës nga muaji korrik 2001 deri më 31 dhjetor 2003, ndërsa nga viti 2004, kjo librari ia ka paguar qiranë bibliotekës në mënyrën, që në vend të parave, ajo i ka dhënë bibliotekës libra. Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses më tej shtoi se paditësja e ka paditur të

paditurin e tretë Shefki Osmani për arsye se ajo nuk ka dëshmi se kush i ka marrë paratë në emër të qirasë, sepse totali i qirasë që ka marrë i padituri i dytë apo i tretë nga data 01.07.2001 deri më 31.03.2005 është 4050 €, e që në raport me të paditurën Komuna e Gjilanit, paditësja kërkon kompensim në të njëjtën shumë, për arsye se Komuna e Gjilanit si bartëse e pushtetit lokal ka detyrimin të mbrojtë integritetin dhe pronën e çdo qytetari, ndërsa në këtë në rast kur drejtori i bibliotekës, tani i padituri, ia ka dhënë këtë objekt një personi të tretë me qira, periudhë për të cilën nuk janë paguar shpenzimet komunale, paditësja i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta miratojë në tërësi si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin e parë Komunën e Gjilanit, që në emër të kompensimit të dëmit të paguajë shumën mujore prej 90 €, ndërsa i padituri i dytë dhe i tretë për shkak të pasurimit të pa bazë t'i paguajnë paditëses shumën prej 90 € në muaj nga data 01.07.2001 deri në pagesën përfundimtare, me kamatën ligjore, si dhe t'ia kompensojnë bashkërisht palës paditëse shpenzimet e papaguara.

21. Më 20 shtator 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.399/2016] vendosi si në vijim: (i) miratoi pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe obligoi Komunën e Gjilanit që parashtrueses së kërkesës t'ia kompensojë dëmin material në vlerë prej 2.000 €, në emër të shkatërrimit të lokalit afarist - barakës, së bashku me kamatën ligjore të cilin e paguajnë bankat për mjetet e depozituara për një vit, pa destinacion të veçantë, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, gjithashtu obligoi të paditurën që parashtrues t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 485 €, në afat prej 15 ditësh, nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë; dhe (ii) refuzoi si të pabazuar pjesën e mbetur të kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës me të cilën ajo ka kërkuar që gjykata ta detyrojë të paditurën Komuna e Gjilanit, Bibliotekën e Qytetit "Fan S. Noli" dhe Shefki Osmanin, nga Gjilani, që së bashku, në emër të pasurimit të pa bazë, për shkak të shfrytëzimit të lokalit afarist në pronësi të paditëses, paditëses t'ia paguajnë shumën monetare prej 12,150 €, gjegjësisht shumën mujore prej 90€, duke filluar nga data 01.07.2001 deri më 06.09.2012, periudhë deri kur është shfrytëzuar ky lokal afarist, së bashku me kamatën ligjore.
22. Në një datë të pasaktësuar parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën si të pabazuar dhe ta anulojë aktgjykimin e kontestuar në lidhje me këtë vendim dhe që çështjen t'ia kthej shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.
23. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i Komunës së Gjilanit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën si të bazuar dhe ta modifikojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit, Departamenti i Përgjithshëm P nr. 399/16, të datës 20 shtatorit 2016, dhe ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke e kthyer çështjen në rivendosje.
24. Më 15 janar 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA.nr.20/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës si dhe ankesën e Komunës së Gjilanit, ndërsa konfirmoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e saj Gjykata e Apelit ndër të tjera theksoi: " në bazë të dispozitave të nenit 200 të LMD-së janë paraparë rregulla të përgjithshme për pasurimin e pa bazë, sipas kësaj, pasurimi i pa bazë është burim i veçantë i të drejtës detyimore, pra kur detyrimet krijohen nga pasurimi i pabazë, është e nevojshme që edhe këto elemente të cilat e krijojnë pasurimin e pa bazë të ekzistojnë. Rritja e pasurisë nga njëra anë dhe pakësimi i pasurisë nga ana tjetër dhe lidhja shkakore mes këtyre dy gjërave, për mungesën e bazës për disa punë

juridike e gjëra të tjera. Nëse marrim për bazë këtë element që e bën pasurimin e pa bazë si të pabazuar dhe kërkesën e paditësit, gjykata ka vlerësuar se këtu nuk bëhet fjalë për pasurimin e pa bazë sepse vendi ku ishte vendosur kioska si dhe i tërë objekti i bibliotekës siç shihet nga shkresat e lëndës është në pronësi të Komunës së Gjilanit dhe udhëhiqet si parcela nr. 4520, sipas listës poseduese nr.1729, ku edhe paditësi i ka bërë kërkesë organit, e që në këtë rast, është e paditura Komuna e Gjilanit, në lidhje me kioskën, prandaj gjykata e shkalles se pare ka konstatuar se kërkesa e paditësit për pasurim te pa baze është kërkesë e pabazuar dhe e paargumentuar, ndërsa për kompensimin e demit material gjykata ka vendosur drejtë në lidhje me kompensimin e demit te shkaktuar nga paditësi* kur ai e hoqi kioskën nga oborri i bibliotekës pa njoftimin paraprak për heqjen e kioskës. Meqenëse nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja nuk ka marrë ose nuk është njoftuar në mënyrën e duhur në lidhje me heqjen e kioskës dhe me atë rast paditëses i është shkaktuar dëm nga aspekti material në lidhje me heqjen e kioskës, në shumën e vlerësuar për kompensimin e demit të të paditurës, vlerësim ky që është bërë nga ana e kompanisë e cila merret me prodhim dhe shitje “Metal Projekt2” për përcaktimin e kompensimit pas vlerësimit të specifikacionit të objektit dhe duke marrë parasysh gjendjen aktuale të kioskës”.

25. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës parashtrroi revizion, duke e atakuar atë në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, ashtu siç është vendosur në paragrafin e parë të vendimit të aktgjyqimit të shkallës së parë, dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që revizioni të miratohet dhe aktgjyqimet e gjykatave më të ulëta të modifikohen, ashtu që kërkesëpadia të miratohet në pjesën refuzuese, apo që aktgjyqimet të refuzohen dhe çështja të kthehet për rigjykim.
26. Më 18 korrik 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjyqimit [Rev.nr.383/2021] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës i parashtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.20/17, të datës 15.01.2021, e i cili ka të bëjë me paragrafin II të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.399/2016, të datës 20.09.2016, përderisa paragrafin e parë të këtij aktgjykimi i cili nuk është i atakuar me revizion, gjykata nuk e ka shqyrtuar.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

27. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia Para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së.
28. Parashtruesja e kërkesës ka ngritur pretendime në lidhje me: shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesja e kërkesës konsideron se “...është plotësisht i paqartë qëndrimi i gjykatave të juridiksionit të rregullt, se në këtë rast nuk ekziston bazë për kompensim në emër të pasurimit pa bazë, pra pasurim të pabazuar nga neni 200 dhe 210 i LMD-së, me arsyetimin se objekti ka qenë i vendosur në tokën për të cilën nuk është ripërtërirë leja, duke shpërfillur me atë rast faktin se në një situatë të tillë ligjore parashtrueses së kësaj kërkesë, përkatësisht bashkëshortit të saj të ndjerë i ka pushuar e drejta e shfrytëzimit të tokës, por ata edhe më tej kanë qenë pronarë të objektit, sepse të njëjtin e kanë ngritur atë ekskluzivisht me mjetet e tyre, ndërsa të paditurit e kanë shfrytëzuar objektin gjatë gjithë kohës deri në rrënimin e tij më datë 06.09.2012, duke ia lëshuar me qira atë personave të tretë dhe nga kjo kanë marrë qiranë, e cila sipas deklarimeve të tyre, ka qenë në shumën mujore prej të paktën 90 eurove”.

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “ *Fakti që Komuna e Gjilanit ishte pronare e tokës nuk i jepte të drejtën e shfrytëzimit të objektit të cilin nuk e kishte ndërtuar me mjetet e veta, dhe është jashtë çdo logjike ligjore të konkludohet nga gjykatat e juridiksionit të rregullt (Themelore , e Apelit dhe Supreme) se për shkak të rrethanës se Komuna e Gjilanit është pronare e tokës në të cilën ndodhej objekti, ajo është e liruar nga pagesa e kompensimit për shkak të shfrytëzimit të sendit të dikujt tjetër, edhe pse Komuna e Gjilanit asnjëherë nuk ka paraqitur kundërpadi të tillë e as kundërshtim të kompensimit. Me këtë veprim të gjykatave të rregullta është vepruar në kundërshtim me parimin e dispozicionit të palës si një nga parimet bazë të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në fakt, ky parim parasheh që gjykata gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore vepron ekskluzivisht brenda kufijve të kërkesës së bërë. Asnjë nga të paditurit nuk kanë paraqitur kërkesat e veta kundër parashtrueses së kërkesës dhe bashkëshortit të saj të ndjerë, për këtë arsye është i paqartë konkluzioni i gjykatave në fjalë kur sipas detyrës zyrtare, e që në procedurë kontestimore nuk lejohet të flitet për të drejtën e të paditurve që të mund të përdorin sendin e të tjerëve”.*
30. Parashtruesja e kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës, pasi që siç thekson “ *E drejta e pronësisë private është krijuar më shumë se 2000 vjet më parë, qysh edhe në të drejtën romake, dhe më pas u adoptua nga të gjitha sistemet juridike të botës, kështu që kjo e drejtë është e drejtë e pacenueshme e çdo individi dhe mund të hiqet ose kufizohet vetëm me procedurë të paraparë me ligj, të cilën e pandehura Komuna e Gjilanit qartazi nuk e ka zbatuar. Kjo e drejtë mbrohet me Protokollin 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në kuptim të dispozitave të nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, por kjo e drejtë mbrohet edhe me nenin 46 të Kushtetutës të Kosovës, i cili garanton të drejtën e pronës”. Tutje parashtruesja e kërkesës thekson se të paditurit janë pasuruar padrejtësisht për shkak të shfrytëzimit të pasurisë së saj, e që kjo sipas saj është pasurim i pabazë.*
31. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 24 Kushtetutës, ku ndër të tjera thekson se : “*...me rastin e shkrimit të padisë, e më pas ankesës dhe revizionit është mbështetur në parimin demokratik nga neni 1 i Kushtetutës së Kosovës, të drejtën për barazi dhe ndalimin e diskriminimit nga neni 24 i Kushtetutës, por edhe në të drejtën e paprekshmërisë së pronës dhe mbrojtjes nga çfarëdo cenim i pronës nga Neni 46 i Kushtetutës, mirëpo duke nxjerrë një vendim të tillë, gjykatat e lartcekura, padyshim kanë dështuar të zbatojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, prandaj parashtruesja si pjesëtare e popullit Serb në Kosovë, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese si mbrojtëse e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që t’i jep zgjidhje kësaj situatë juridike dhe si mbrojtëse e Kushtetutës, të konstatojë shkeljet individuale të Kushtetutës në të cilat është thirrur parashtruesja e kësaj kërkesë, duke pasur parasysh se për shkak të pamundësisë për t’iu drejtuar Gjykatës Evropiane në Strasburg, Gjykata Kushtetuese e Kosovës përfaqëson instancën e fundit në mbrojtjen e të drejtave individuale kushtetuese të cenuara të çdo qytetari në këtë rajon”.*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 46 **[Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 **(E Drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Neni 13 **(E drejta për zgjidhje efektive)**

Çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14 **(Ndalimi i diskriminimit)**

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 200

Përdorimi i sendit në dobi të tjetrit

Në qoftë se dikush e ka përdorur sendin e vet apo të tjetrit në dobi të tretit, kurse nuk ka kushte për aplikimin e rregullave mbi gjerimin e punëve të huaja pa porosi, i treti ka për detyrë ta kthejë sendin, respektivisht, po qe se kjo s'është e mundur, t'ia shpërblej vlerën e sendit.

Neni 210

Gjerimi i paautorizuar për llogari personale

1. Kush e kryen punën e huaj me qëllim që për vete t'ia mbajë përfitimet e arritura, edhe pse e di se puna është e huaj, ka për detyrë që me kërkesë të zotit të punës të japë llogari si punë drejtues pa porosi dhe t'ia dorëzojë të gjitha përfitimet e arritura.

2. I zoti i punës mund të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme si dhe shpërblimin e dëmit.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

34. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

35. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.383/2021] e 18 korrikut 2022 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
36. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
37. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), me parashtruese Nexhmije Makolli, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe KI175/20, me parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur,

përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" shih rastet e GjEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

39. Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
40. Rrethanat e rastit konkret, ndërliiden me një kontest lidhur me një objekt kioskë të cilën bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës e kishte vendosur në truallin e Komunës së Gjilanit përkatësisht në oborrin e Bibliotekës së Qytetit, dhe të cilën kioskë e kishte përdorur si zyre për ushtrimin e profesionit të tij të avokatit deri në korrik të vitit 1999. Më pastaj siç thekson parashtruesja kioska në fjalë i ishte uzurpuar dhe ishte hapur një kafiteri e cila kishte punuar deri në shtator të 1999. Lokali në fjalë më tej ishte marrë në posedim nga ana e Bibliotekës së Qytetit dhe i ishte lëshuar me qira një personi te tretë ku ishte shfrytëzuar për librari. Parashtruesja e kërkesës më tej kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore kundër Komunës së Gjilanit – Biblioteka e Qytetit dhe Shefki Osmani nga Gjilani, për shkak të pasurimit të pabazë, pasi që siç deklaroi, Biblioteka e Qytetit "Fan S. Noli" në Gjilan dhe i padituri i tretë Shefki Osmani, ish-drejtor i bibliotekës, pa asnjë bazë ligjore dhe pa autorizim i kanë dhënë me qira lokalin afarist të paditëses, librarisë "Toena" në Gjilan, për shumën monetare mujore prej 90 €, që kjo librari ia ka paguar bibliotekës nga muaji korrik 2001 deri më 31 dhjetor 2003, ndërsa nga viti 2004, kjo librari ia ka paguar qiranë bibliotekës në mënyrën, që në vend të parave, ajo i ka dhënë bibliotekës libra. Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses më tej shtoi se paditësja e ka paditur të paditurin e tretë Shefki Osmani për arsye se ajo nuk ka dëshmi se kush i ka marrë paratë në emër të qirasë, sepse totali i qirasë që ka marrë i padituri i dytë apo i tretë nga data 01.07.2001 deri më 31.03.2005 është 4050 €, e që në raport me të paditurën Komuna e Gjilanit, paditësja kërkon kompensim në të njëjtën shumë, për arsye se Komuna e Gjilanit si bartëse e pushtetit lokal ka detyrimin të mbrojë integritetin dhe pronën e çdo qytetari, ndërsa në këtë në rast kur drejtori i bibliotekës, tani i padituri, ia ka dhënë këtë objekt një personi të tretë me qira, periudhë për të cilën nuk janë paguar shpenzimet komunale, paditësja i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta miratojë në tërësi si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin e parë Komunën e Gjilanit, që në emër të kompensimit të dëmit të paguajë shumën mujore prej 90 €, ndërsa i padituri i dytë dhe i tretë për shkak të pasurimit të pa bazë t'i paguajnë paditëses shumën prej 90 € në muaj nga data 01.07.2001 deri në pagesën përfundimtare, me kamatën ligjore, si dhe t'ia kompensojnë bashkërisht palës paditëse shpenzimet e papaguara. Gjykata Themelore miratoi pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe obligoi Komunën e Gjilanit që parashtrueses së kërkesës t'ia kompensojë dëmin material

në vlerë prej 2.000 €, në emër të shkatërrimit të lokalit afarist - barakës, së bashku me kamatën ligjore të cilin e paguajnë bankat për mjetet e depozituara për një vit, pa destinacion të veçantë, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, gjithashtu obligoi të paditurën që parashtrues t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 485 €, në afat prej 15 ditësh, nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë; dhe (ii) refuzoi si të pabazuar pjesën e mbetur të kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës me të cilën ajo ka kërkuar që gjykata ta detyrojë të paditurën Komuna e Gjilanit, Bibliotekën e Qytetit “Fan S. Noli” dhe Shefki Osmanin, nga Gjilani, që së bashku, në emër të pasurimit të pa bazë, për shkak të shfrytëzimit të lokalit afarist në pronësi të paditëses, paditëses t'ia paguajnë shumën monetare prej 12,150 €, gjegjësisht shumën mujore prej 90€, duke filluar nga data 01.07.2001 deri më 06.09.2012, periudhë deri kur është shfrytëzuar ky lokal afarist, së bashku me kamatën ligjore. Parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit lidhur me pikën II të aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila ankesë u refuzua nga ana e Gjykatës së Apelit dhe u vërtetua aktgjykimi i Gjykatës Themelore. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, i cili revizion u refuzua.

41. Gjykata verën se esenca e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore nga ana e gjykatave të rregullta përkatësisht nenit 200 dhe 210 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD) duke aluduar në pasurimin e pabazë. Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla ngrejnë çështje nga neni 31 i Kushtetues dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata fillimisht do trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke vazhduar më pas me pretendimin lidhur me shkeljen e nenit 24 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenin 13 dhe 14 të KEDNJ-së.

i. Perkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

43. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës qëndron në pretendimin se Gjykatat e rregullta kanë shkelur nenin 31 të Kushtetutës, pasi që vendimet e tyre i kanë bazuar në dispozita të gabuara ligjore, duke arsyetuar: *“...është plotësisht i paqartë qëndrimi i gjykatave të juridiksionit të rregullt, se në këtë rast nuk ekziston bazë për kompensim në emër të pasurimit pa bazë, pra pasurim të pabazuar nga neni 200 dhe 210 i LPK-së, me arsyetimin se objekti ka qenë i vendosur në tokën për të cilën nuk është ripërtërirë leja, duke shpërfillur me atë rast faktin se në një situatë të tillë ligjore parashtrueses së kësaj kërkesë, përkatësisht bashkëshortit të saj të ndjerë i ka pushuar e drejta e shfrytëzimit të tokës, por ata edhe më tej kanë qenë pronarë të objektit, sepse të njëjtin e kanë ngritur atë ekskluzivisht me mjetet e tyre, ndërsa të paditurit e kanë shfrytëzuar objektin gjatë gjithë kohës deri në rrënimin e tij më datë 06.09.2012, duke ia lëshuar me qira atë personave të tretë dhe nga kjo kanë marrë qiranë, e cila sipas deklarimeve të tyre, ka qenë në shumën mujore prej të paktën 90 eurove”.*
44. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykatat e rregullta, përkatësisht të nenit 200 dhe 210 të LMD-së.

45. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtruese *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
46. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, *paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, KI49/19*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
47. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
48. Së pari, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [P.nr.399/2016], miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës ku obligoi Komunën e Gjilanit që parashtruesen ta kompensojë në vlerë prej 2000 euro, në emër të shkatërrimit të lokalit afarist – barakës, ndërsa refuzoi kërkesëpadinë kundër Komunës së Gjilanit dhe Shefki Osmanit lidhur me pasurimin e pabazë për shkak të shfrytëzimit të lokalit, gjegjësisht kërkesën e saj që ti paguante shumën prej 12,150 euro përkatësisht shumën prej 90 euro, duke filluar nga data 01.07.2001 deri më 06.09.2012, periudhë deri kur është shfrytëzuar ky lokal afarist. Në lidhje me pretendimet për pasurim të pa bazë, Gjykata Themelore konstatoi se: “... Marrë parasysh se ish paditësi *Goroļjub Paviq dhe tani përfaqësuesi i autorizuar i paditëses Svetlana Paviq*, nuk paraqitën prova në gjykatë për përdorimin e tokës bazuar në nenin 10, Vendimin nr.01-1894-020, të datës 11 prill 2001, për objektet e përkohshme të vendosura në territorin e Komunës së Gjilanit, për pagesën e sipërfaqes publike, për kompensimin vjetor për m2 të sipërfaqes në të cilën është vendosur objekti, gjykata konsideron se kjo kontratë është shkëputur dhe se paditësja nuk gëzon këtë të drejtë, dhe një kërkesë e tillë e ish paditësit dhe tani aktualisht e paditëses, në lidhje me pasurimin e pa bazë, është refuzuar nga ana e gjykatës si e pabazuar”.
49. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [CA.nr.20/2017], refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, se gjykatat kanë bërë interpretim të gabuar të drejtës materiale lidhur me pasurimin e pa bazë, Gjykata e Apelit vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara, meqenëse

“në bazë të dispozitave të nenit 200 të LMD-së janë paraparë rregulla të përgjithshme për pasurimin e pa bazë, sipas kësaj, pasurimi i pa bazë është burim i veçantë i të drejtës detyrimore, pra kur detyrimet krijohen nga pasurimi i pabazë, është e nevojshme që edhe këto elemente të cilat e krijojnë pasurimin e pa bazë të ekzistojnë. Rritja e pasurisë nga njëra anë dhe pakësimi i pasurisë nga ana tjetër dhe lidhja shkakore mes këtyre dy gjërave, për mungesën e bazës për disa punë juridike e gjëra të tjera. Nëse marrim për bazë këtë element që e bën pasurimin e pa bazë si të pabazuar dhe kërkesën e paditësit, gjykata ka vlerësuar se këtu nuk bëhet fjalë për pasurimin e pa bazë sepse vendi ku ishte vendosur kioska si dhe i tërë objekti i bibliotekës siç shihet nga shkresat e lëndës është në pronësi të Komunës së Gjilanit dhe udhëhiqet si parcela nr. 4520, sipas listës poseduese nr.1729, ku edhe paditësi i ka bërë kërkesë organit, e që në këtë rast, është e paditura Komuna e Gjilanit, në lidhje me kioskën, prandaj gjykata e shkalles se pare ka konstatuar se kërkesa e paditësit për pasurim te pa baze është kërkesë e pabazuar dhe e paargumentuar, ndërsa për kompensimin e dëmit material gjykata ka vendosur drejtë në lidhje me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga paditësi kur ai e hoqi kioskën nga oborri i bibliotekës pa njoftimin paraprak për heqjen e kioskës. Meqenëse nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja nuk ka marrë ose nuk është njoftuar në mënyrën e duhur në lidhje me heqjen e kioskës dhe me atë rast paditëses i është shkaktuar dëm nga aspekti material në lidhje me heqjen e kioskës, në shumën e vlerësuar për kompensimin e dëmit të të paditurës, vlerësim ky që është bërë nga ana e kompanisë e cila merret me prodhim dhe shitje “Metal Projekt2” për përcaktimin e kompensimit pas vlerësimit të specifikacionit të objektit dhe duke marrë parasysht gjendjen aktuale të kioskës”.

50. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Rev.383/2021], e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesja e kërkesës. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata Supreme ndër të tjera theksoi se: *“... Janë të pabazuara pretendimet e revizionit të paditëses se aktgjykimi i atakuar është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n) i LPK-së, se dispozitivi i aktgjykimin është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresa të lëndës , se arsyetimi nuk përmban arsytet për faktet vendimtare. Në lidhje me këtë, kjo Gjykatë konsideron, dhe vlerëson se pretendimet e tilla janë të pabaza, duke pasur parasysht se aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të procedurës, dispozitivi është në përputhje me provat e paraqitura, sepse gjykata ka gjetur se paraardhësi i paditëses, tashmë bashkëshorti i ndjerë Goroljub Pavic, me palën e paditur kishte lidhur kontratën nr. 784-25, të datës 14.11.2008, me të cilën i ishte dhënë në shfrytëzim toka ndërtimore për ushtrimin e veprimtarisë së paditësit. E paditura e rrënoi objektin e përkohshëm e paditëses, për shkak se në bazë të kontratës ajo kishte të drejtë ta bënte këtë në situatën kur ndërrohet destinimi i objektit. Nga kjo del se e paditura ka vepruar në përputhje me dispozitat e kontratës dhe në veprimet e saj nuk ka pasur veprime të kundërligjshme që është një prej kushteve për shpërblimin e dëmit. E paditura më datë 01.04.2009, e ka njoftuar me shkrim paditësen në lidhje me largimin e objektit të përkohshëm, i cili përndryshe është larguar më datë 06.09. 2012. Në një objekt të përkohshëm të ndërtuar pa lejen ndërtimore nga organi kompetent, pronari gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, e cila vlen për sa kohë që ai objekt ekziston si i tillë, dhe deri në kohën që sipas procedurës së përcaktuar me ligj, ai të rrënohet nga ana e organit kompetent. Meqenëse kërkesa e paditëses është pasurimi pa bazë, për shkak se objekti është shfrytëzuar nga e paditura e dytë dhe paditësja nuk ka parashtruar prova se objekti i përkohshëm është ndërtuar me leje, prandaj në këtë drejtim pretendimet e paditëses në revision se paditëses i takon kompensimi në bazë të pasurimit të pabazë janë të pabazuara”.*
51. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja e vlerësimit lidhur me pasurimin e pa bazë është çështje që përcaktohet nga gjykatat e rregullta në kuadër të detyrave dhe

prerogativës së tyre për konstatim të gjendjes faktike dhe zbatim të ligjit material e procedural në rastet individuale dhe se në këtë drejtim nuk mund të thuhet se janë cenuar garancitë procedural nga neni 31 i Kushtetutës. Veç kësaj, gjykatat e rregullta kanë shpjeguar se nuk kemi të bëjmë me pasurim të pa bazë, sepse vendi ku ishte vendosur kioska ishte pronë komunale dhe se parashtruesja e kërkesës nuk kishte parashtruar prova se objekti në fjalë ishte ndërtuar me leje.

52. Gjykata nuk vëren zbatim të dukshëm arbitrar të ligjit apo të fakteve, konkluzion qartazi të paarsyeshëm të procedurave apo edhe mungesë të marrëdhënies logjike ndërmjet fakteve të konstatuara dhe zbatimit të dispozitave ligjore përkatëse ndaj atyre fakteve. Në të vërtetë, nga vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetim të bollshëm lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës.
53. Për sa më sipër, Gjykata konstaton që parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e saj; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
54. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, thekson se, Gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht dispozitat e nenit 200 dhe 210 të LMD-së, megjithatë ajo nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit së kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (shih rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).
55. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se Gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ku në bazë të provave të nxjerra ishte vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe me këtë rast, të njëjtat ishin shpallur si të pabazuara. Sa më sipër, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur që pretendimet e saj për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë t'i ngrejë në nivel kushtetutshmërie.

ii. Përkitazi me pretendimet e tjera

56. Siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e saj të garantuara me nenin 22, 24 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenin 13 dhe 14 të KEDNJ-së. Mirëpo, parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe

përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI187/18 dhe KI 11/19](#), parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [KI125/19](#) parashtrues: *Ismaj Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).

57. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimin për shkelje të neneve 22, 24 dhe 46 të Kushtetutës lidhur me nenet 13 dhe 14 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës, në të vërtetë, i ka elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave themelore me interpretimin e gabuar të ligjit lidhur me pasurimin e pabazë, për çfarë Gjykata sa më sipër konstatoi se në këtë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, për arsyt e lartcekura.
58. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e lartcekura të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, sepse parashtruesja e kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si ishin shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

59. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 22, 24 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenit 13 dhe 14 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime shpallën qartazi të pabazuara.
60. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, bazuar në rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe 48 (2) të Rregullores së punës, më 7 nëntor 2023 njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani